



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE, PRONAVE DHE TRANSPORTIT

RELACION

MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PER FAMILJEN E Z. RRAPO SINANI DHE ZNJ. MARELA NOVA, TË MBETUR TË PASTREHË NGA NGA ZJARRI I RENE DATE 08.03.2021

Të nderuar Këshilltare !

Të gjithë jemi prekur nga ngjarja e rëndë e shkaktuar nga zjarri i rene më datë 08.03.2021 ora 00.12 minuta në banesën e Jani Vangjelit „Lagja “Muzakaj” ,ku përfundimi ishte tragjik me humbjen e dy jeteve dhe shkatërrimin e tre banesave .

Si rezultat i kësaj ngjarje mbetën të pastrehe dy familje, familja e z. Rrapo Sinani dhe znj. Marela Nova ,pasi banesat e tyre ndodhen shume afër banesës ku ra zjarri dhe si rezultat i përhapjes së zjarrit me shpejtësi ,të dyja banesat u dogjën plotesisht.

Për ti ardhur në ndihme dy familjeve në këtë situatë tepër të vështirë ,bashkia mer përsipër ti ndihmojë me bonus të qirasë së banesës të gjetur vet nga qytetarët në tregun e lire , me afat 1 vjeçar.

Nga sa më sipër të dy familjet e dëmtura kanë dorëzuar pranë bashkisë ,kërkesën për ndihmë së bashku me dokumentacionin e përbërë nga certifikata familjare si dhe kontraten e qirasë së banesës të lidhur para zyrës noteriale .

- Znj. Marela Nova ,me perberje familjare tre persona , kontratë qiraje nr.456/269 date 11.03.2021, sipërfaqe 100 m2, vlerë të qirasë prej 18,000 lekë /muaj dhe afat 1 vjeçar.
- Z. Rrapo Sinani me perberje familjare dy persona dhe familja e djalit Stiljano Sinani e përbërë nga tre persona , kontratë qiraje nr.903/386 date 11.03.2021, sipërfaqe 107 m2 , vlerë të qirasë prej 22,000 lekë /muaj dhe afat 1 vjeçar.

Drejtör i E.P.T
Erlin Kuçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2021

MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR FAMILJEN E Z. RRAPO SINANI DHE ZNJ. MARELA NOVA, TË MBETUR TË PASTREHË NGA NGA ZJARRI I RENE DATE 08.03.2021

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 9, pika 1.1, neni 24, neni 54, neni 64 gërma "c"; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", VKM Nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret per procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

VENDOSI:

1. Të miratoj , bonusin e qirase për familjen e znj. Marela Nova në vlerën 18,000 lekë /muaj me afat 1 vjeçar.
2. Të miratoj , bonusin e qirase për familjen e z. Rrapo Sinani në vlerën 22,000 lekë /muaj me afat 1 vjeçar.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , Drejtoria e Emergjencave Civile, Pronave dhe Transportit.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca